

**LIGJI NR. 04/L-212**

**PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E LIGJIT NR. 03/L-174 PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE, TË NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-058**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E LIGJIT NR. 03/L-174 PËR FINANCIMIN E SUBJEKTEVE POLITIKE, TË NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-058**

**Neni 1**

1. Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058.

2. Termi “**ligji bazik**” i përdorur në dispozitat e këtij ligji i referohet i Ligjit nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058.

**Neni 2**

1. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.5. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.5. **Kontributet** - dhuratat (donacionet) ose ndihma e cilido lloj që nënkupton një akt të ndërgjegjshëm për t'i dhuruar të mira ekonomike apo të ngjashme për subjektin politik, qoftë në para të gatshme, shërbime, shitja e gjësendeve nën çmimin e tregut, ofrimi i shërbimeve nën çmimin e tregut apo në të mira tjera materiale.

2. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.10. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.10. **Subjekti politik** – parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur. Për qëllime të këtij ligji, për subjektet si Organizatat e të Rinjve, Fondacionet, Institutet apo trupa të ngjashme që janë të krijuara nga subjektet politike apo që kanë lidhje me subjektet politike ose që kryejnë aktivitete funksionale për subjektet politike do të vlejnjë të njëjtat dispozita të këtij ligji sa i përket raportimit financiar tyre.

3. Neni 2 i ligjit bazik, paragrafi 1.12. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.12. **Shpenzimet për fushatë** – të gjitha shpenzimet dhe pagesat e bëra për mallra dhe shërbime në pajtim me Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, dhe Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

**Neni 3**

1. Neni 4 i ligjit bazik, pas paragrafit 1, shtohen paragrafët e rinjë 2., 3., 4. dhe 5. me tekstin në vazhdim:

2. Të gjitha të hyrat financiare dhe materiale të subjekteve politike duhet të regjistrohen në regjistrat e subjekteve politike. Të hyrat e realizuara në formë të shërbimeve duhet të regjistrohen në kundërvlerën monetare të shërbimit.

3. Të gjitha subjektet politike duhet të kenë një llogari të vetme bankare në njërin nga bankat komerciale të regjistruara në Republikën e Kosovës, përmes të cilës do të kryejnë të gjitha transaksionet.

4. Të gjitha të hyrat financiare të lejuara me dispozitat e këtij ligji, përveç kuotave të anëtarësisë dhe të hyrave të realizuara nga shitja e të mirave materiale të përcaktuara në nenin 6, paragrafi 1. të ligjit bazik, do të realizohen përmes transaksionit bankar. Të hyrat nga kuotat e anëtarësisë dhe të hyrat e parapara sipas nenit 6, paragrafi 1. të ligjit bazik, të cilat mund të realizohen në para të gatshme duhet të derdhen në llogarinë e vetme bankare të subjektit politik më së largu 5 (pesë) ditë nga dita e pranimit të tyre.

5. Në rast se një subjekt politik ka pranuar mjete financiare në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, subjekti i tillë politik duhet që brenda dy (2) javësh nga data e pranimit të këtyre mjeteve të kthejë ato përmes llogarisë bankare në burimin e pranimit, dhe brenda të njëjtit afat ta informojë KQZ-në.

#### **Neni 4**

1. Neni 9 i ligjit bazik, pas paragrafit 2. shtohen dy paragraf të rinjë 3. dhe 4. me tekstin si në vijim:

3. Në rast të bashkimit të dy apo më shumë subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës në një subjekt të ri, subjekti suksesor merr mjetet e ndara nga Fondi, konform përfaqësimit të tij në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

4. dhjetë përqind (10%) e shumës së ndarë nga Fondi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, të shkojnë për mbështetjen e punës së secilit deputet.

2. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 3 rinumërohet si paragrafi me numër 4.

#### **Neni 5**

2. Neni 10, paragrafi 1. i ligjit bazik riformulohet si vijon:

1. Për financimin e fushatave zgjedhore qendrore dhe lokale, për zgjedhjet të rregullta dhe të jashtëzakonshme, me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës mund të ndaj mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës për Fondin, por jo më shumë se 0.05% të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

#### **Neni 6**

1. Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 1. pas nënparagrafit 1.5. shtohen nënparagrafët e rinjë 1.6., 1.7., 1.8. dhe 1.9., me tekstin si në vijim:

1.6. Ndërmarrjet private gjersa janë në marrëdhënie kontraktuale për ofrimin e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve me institucionet e Republikës së Kosovës dhe tre (3) vite pas përfundimit të marrëdhënies kontraktuale;

1.7. Organizatat jo qeveritare, organizatat humanitare, organizatat fetare dhe organizatat sindikale;

1.8. Personat fizik dhe juridik të cilët janë debitorë ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës, kundër të cilëve është iniciuar procedurë përmbarimi;

1.9. Organizatat e të Rinjve, Fondacionet, Institutet apo trupa të ngjashme që janë të krijuara nga subjektet politike apo që kanë lidhje me subjektet politike ose që kryejnë aktivitete funksionale për subjektet politike;

2. Në Nenin 11 të ligjit bazik, në paragrafin 3, fjalët “**në llogari bankare**” zëvendësohen me fjalët “**përmes llogarisë së vetme bankare**”, pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

3. Neni 11 i ligjit bazik, pas paragrafit 3, shtohet paragrafi i ri 4. me tekstin si në vijim:

4. Kandidatët e subjekteve politike nuk mund të pranojnë asnjë donacion jashtë rregullave të përcaktuara përmes këtij ligji për financimin e subjekteve politike. Asnjë donacion nuk mund të bëhet drejtpërdrejtë për kandidatin, por duhet të kalojë përmes subjektit politik, duke respektuar dispozitat e këtij ligji.

#### **Neni 7**

1. Neni 13, paragrafi 2 i ligjit bazik, fshihet nga teksti i ligjit.

#### **Neni 8**

1. Neni 15 i ligjit bazik., paragrafi 3. Nën-paragrafi 3.2. togfjalëshi “**që tejkalojnë shumën prej njëqind (100) Eurosh**” fshihet nga teksti i ligjit

2. Neni 15 i ligjit bazik, nën-paragrafi 3.5. fshihet nga teksti i ligjit.

3. Neni 15 i ligjit bazik, paragrafit 4. fshihet nga teksti i ligjit.

4. Neni 15 i ligjit bazik, paragrafi 5. ri numërohet si paragraf 4.

5. Neni 15 i ligjit bazik, pas paragrafit 4. shtohet një paragrafi i ri me numër 5., me tekstin si në vijim:

5. Subjektet politike duhet të publikojnë dhe të mbajnë të publikuar së paku një (1) vit në faqet e tyre zyrtare Raportin Vjetor Financiar të vitit paraprak dhe Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës së zgjedhjeve paraprake dhe ta publikojnë versionin tyre të shkurtuar në njërën nga gazetatat ditore kombëtare. Formatin e versionit të shkurtër për publikim e përcakton KQZ-ja përmes një akti nënligjor.

5.1. Raporti Vjetor Financiar i subjektit politik duhet të publikohet në mjetet e informimit të parapara në paragrafin 5. të këtij neni deri më 30 korrik të vitit pasues.

5.2. Raporti i Deklarimit Financiar të Fushatës së subjektit politik duhet të publikohet në mjetet e informimit të paraparë në paragrafin 5. të këtij neni më së larg gjashtë (6) muaj pas ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

#### **Neni 9**

Neni 17 i ligjit bazik, paragrafi 1., riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Subjektet Politike janë të detyruara të definojnë në statut mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të tyre dhe, me qëllim të luftimit të praktikave korruptive dhe ngritjes dhe forcimit të menaxhimit financiar dhe transparencës, subjektet politike duhet të zhvillojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm financiar.

#### **Neni 10**

1. Neni 18 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

#### **Neni 18 Mospagimi i detyrimeve**

1. Në rastet kur një subjekt politik nuk paguan detyrimet, të tilla si gjobat e shqiptuara nga KQZ-ja, detyrimet tatimore, apo detyrimet që burojnë nga përmbarimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, atëherë shuma përkatëse i zbritet nga buxheti i që i ndahet nga Fondi.

2. Në rast se shuma e detyrimeve të subjektit politik është më e madhe sesa buxheti të cilin e realizon nga Fondi, subjekti politik nuk mund të merr pjesë në zgjedhje pa e paguar borxhin e tij.

## Neni 11

1. Neni 19 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

### Neni 19 Kontrolli financiar

1. Raportet Vjetore Financiare dhe Raport të Deklarimit Financiar të Fushatës të cilat dorëzohen nga subjektet politike në KQZ, do të auditohen në përputhje me standardet e kontabilitetit të zbatueshme në Kosovë, nga auditorë të cilët do të përzgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike nëpërmjet një thirrje të hapur publike për aplikim.

2. Për zbatimin e obligimit që buron nga paragrafi 1. i këtij neni, Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në muajin janar të çdo viti përzgjedh me konkurs publik së paku dhjetë (10) auditorë të licencuar të cilët do të auditojnë Raportet Vjetore Financiare dhe Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së subjekteve politike. Për t'u përzgjedhur auditorët ndër të tjera duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

2.1. të jenë auditor të licencuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës;

2.2. të kenë përvojë pune së paku dy (2) vjeçare në fushën e auditimit;

2.3. personat fizik ose juridik të përzgjedhur të mos kenë pasur raporte kontraktuale me ndonjërin nga subjektet politike gjatë tre (3) viteve e fundit;

2.4. të mos kenë qenë donatorë të ndonjërit nga subjektet politike apo të kenë përfituar në ndonjë mënyrë nga subjektet politike gjatë tre (3) viteve të fundit;

2.5. të mos jetë nën hetime apo i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale;

2.6. të paraqes një listë me të gjitha auditimet që ka kryer gjatë tre (3) viteve të fundit.

3. Në rast të aplikimit të personave juridik për tu përzgjedhur për auditor nga paragrafi 1. i këtij neni, personi i tillë juridik dhe personat fizik të cilët janë pjesë përbërëse e personit juridik duhet t'i përmbushin të gjitha kriteret sipas paragrafit 2. i këtij neni. Personi i tillë juridik duhet gjithashtu të paraqes listën e të gjithë punëtorëve.

4. Pas përzgjedhjes së listës së auditorëve të cilët do të bëjnë auditimin nga paragrafi 1. i këtij neni, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kjo listë do të caktojë me short auditorët të cilët do të jenë përgjegjës për auditimin e raporteve të subjekteve politike. Një auditor nuk mund të auditojë dy herë radhazi raportet financiare të një subjekti politik.

5. Subjekti i regjistruar politik bashkëpunon ngushtë me Auditorët e përzgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe u ofron atyre qasje të plotë dhe të papenguar në shënimet financiare të partisë, duke përfshirë të gjitha shënimet pa kufizime.

6. KQZ - ja ia paraqet rezultatet paraprake të kontrollimit të raportit vjetor financiar nga auditorët organit më të lartë ekzekutiv të subjektit politik, duke përfshirë edhe listën e gabimeve ose lëshimeve brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga fillimi i kontrollimit.

7. Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e rezultateve paraprake të kontrollimit mund ta dorëzojë raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimin lidhur me çdo gabim të dukshëm ose lëshim të identifikuar nga auditorët.

8. Pas pranimit të raportit të rishikuar financiar nga subjekti politik dhe shpjegimet për gabimet dhe lëshimet e identifikuar, Auditorët e përzgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike brenda dhjetë (10) ditëve dorëzojnë KQZ-së Raportin Përfundimtar të Auditimit ku janë të identifikuar çdo gabim ose lëshim në raportin financiar, duke marrë parasysh çdo shpjegim ose rishikim të dorëzuar nga subjekti politik.

9. Procesi i auditimit të Raporteve vjetore financiare të subjekteve politike duhet të mbarojë më së largu deri më 15 qershor të vitit pasues.

10. KQZ-ja duhet t'i publikoj dhe t'i mbaj të publikuar të gjitha raportet vjetore financiare të subjekteve politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike në faqen e saj zyrtare më së largu deri më 30 qershor të vitit pasues. Po ashtu, deri më këtë datë KQZ-ja obligohet t'i përcjellë subjektit politik raportin përfundimtar të auditimit.

11. KQZ-ja obligohet t'i përcjellë deri më 30 qershor të vitit pasues raportet vjetore financiare të subjekteve politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike dhe më së largu deri më gjashtë (6) muaj pas ditës së mbajtje së zgjedhjeve raportin financiar të fushatës së subjekteve politike së bashku me raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike për në Agjencinë Anti Korrupsion, e cila në përputhje me mandatin të saj mund të ekzaminoj këto raporte.

12. KQZ-ja përgatit një raport vjetor për Kuvendin e Republikës së Kosovës për shpërndarjen dhe shpenzimin e mjeteve nga Fondi.

## **Neni 12**

1. Neni 21 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

### **Neni 21**

#### **Dispozitat ndëshkimore**

1. Subjekti politik gjobitet me gjobë bazike me dhjetë përqind (10%) të shumës së realizuar nga Fondi në vitin paraprak nëse nuk e paraqet Raportin Vjetor Financiar dhe Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës në afatin e paraparë me ligj, dhe me gjobë ditore prej 0.01 % të shumës së gjobës bazë, deri në paraqitjen e raportit. Subjekti politik i cili nuk merr mjete nga Fondi gjobitet me gjobë bazike me njëmijë (1000) Euro me gjobë ditore prej 0.01 % të shumës së gjobës bazë, deri në paraqitjen e raportit. Subjekti politik i cili nuk e paraqet Raportin Vjetor Financiar dhe Raportin e Deklarimit Financiar të Fushatës brenda afatit të përcaktuar me ligj humb drejtën për të përfutuar mjete nga Fondi për vitin e ardhshëm.

2. Subjekti politik gjobitet për mospërmbushjen e kriterëve të raportit financiar të përcaktuar në ligj si vijon:

2.1. subjekti politik, për informatat e pasakta dhe jo të plota të dhëna lidhur me bilancin e gjendjes, pasqyrën e fitimit dhe të humbjeve dhe pasqyrën e pagesës mbi vlerën pesëmijë (5.000) Euro të bërë personave tjerë, gjobitet me gjobë bazë prej pesë mijë (5.000) Euro si dhe me gjobë ditore prej 0.01% të shumës bazë deri në përmirësimin e këtyre të dhënave.

2.2. subjekti politik gjobitet me gjobë bazë me dymijë (2.000) Euro për mungesën e kopjeve të dokumentacionit të raportit financiar të paraparë në paragrafin 3. të nenit 15 të ligjit bazik.

3. Subjektet politike gjobiten me gjobë bazë në shumën prej pesëmijë (5.000) Euro për mospublikimin e Raporteve Financiare të paraparë në nenin 15, paragrafi 5. të ligjit bazik dhe me gjobë ditore në vlerë prej 0.01% të vlerës së gjobës bazë deri në publikimin e tyre .

4. Subjekti politik gjobitet me dyfishin e vlerës së pranuar ndërsa kandidati për kryetar komune, kandidati për deputet, këshilltar komunal dhe kandidati i pavarur gjobitet me vlerën e njëjtë të pranuar nëse;

4.1. pranon dhe ekzekuton donacionin nga personi fizik në kundërshtim me nenin 5 , paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të ligjit bazik;

4.2. pranon dhe ekzekuton donacion nga personi juridik në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të ligjit bazik;

4.3. pranon dhe ekzekuton donacion në kundërshtim me nenin 11 të ligjit bazik;

4.4. pranon dhe ekzekuton donacion deri në njëzetmijë (20.000) Euro, origjina e të cilëve nuk mund të dëshmohet;

5. Subjekti politik i cili nuk mund të dëshmojnë origjinën e të hyrave të pranuar dhe të ekzekutuara mbi njëzetmijë (20.000) Euro do të gjobiten me trefishin e asaj shume.

6. Personat fizik dhe juridik të cilët japin kontribute në kundërshtim me nenin 5 dhe nenin 11 të ligjit bazik, gjobiten me 20% të vlerës së dhënë.

7. Të gjitha të hyrat realizuara nga subjekti politik jashtë burimeve të parapare me nenin 4 të ligjit bazik do të derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe subjektet politike do të gjobiten me dhjetë përqind (10%) të shumës së realizuar.

8. Subjektet politike gjobiten me dyfishin e mjeteve financiare të harxhuara në kundërshtim me nenin 8 dhe nenin 10 të ligjit bazik.

9. Subjekti politik gjobitet me gjobë bazike me pesëmijë (5.000) Euro për mbajtjen aktive të dy apo më shumë llogarive bankare dhe me gjobë ditore prej 0.01 % të shumës së gjobës bazë gjer në mbylljen e këtyre llogarive.

10. Subjekti politik gjobitet me shumën njëmijë (1.000) Euro për mos njoftimin e KQZ-së në afatin e paraparë në nenin 3, paragrafi 5. të këtij ligji, për mjetet e pranuar në kundërshtim me këtë ligj.

11. Nëse në keqpërdorim të fondeve është i përfshirë kandidati apo subjekti politik dhe të vërtetohet se fitimi i mandatit/mandateve është si rezultat i keqpërdorimit të fondeve në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, kandidati apo subjektit politik i merret mandati.

12. Subjektet politike kanë të drejtë ankese ndaj dispozitave ndëshkimore. Ankesat i drejtohen Panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtresa në bazë të legjislacionit në fuqi.

13. Të hyrat nga gjobat sipas këtij ligji derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Neni 13**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji nr. 04/L-212**  
**31 korrik 2013**

[Shpallur me dekretin Nr. DL-046-2013, datë 19.08.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga](#)